

BASHKIA TIRANË

Data 16.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)***OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje aparat fotografik profesional” (për Policinë Bashkiake)**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje fotografike 38650000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,332,760 (një milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta , formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Permbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP I ndryshuar, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës;

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

Ose

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162 i ndryshuar, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikata që kërkohet duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit:

ISO 9001:2015 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenin 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të*

dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e certifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike dhe në varësi të zërave përkatës të preventivit. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Certifikimi ISO 9001 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Paraqitja e ISO-s tregon se, OE zbaton sistemet e menaxhimit në përputhje me këto standarde dhe rrisin performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues. ISO duhet të jenë në emër të shoqërive dhe në objektet e këtyre certifikatave duhet të jetë përfshirë objekti i prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt kryesorë objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5 të shtojcës 7, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit që e ka lëshuar këtë dokument, si: telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogë/ broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/eve dhe të plotësojë tabelën me të dhënat sipas formatit të mëposhtëm, për artikujt kryesorë objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5 të shtojcës 7, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike me kërkesat në DT.

A	B	C	D	E
Nr. rendor shtojca 7	Emërtimi i artikullit	Duhet paraqitur MAF/DAF per pajisjet	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	Aparat fotografik profesional			
2	Lente 70-200 mm			
3	Lente 35mm			
4	Lente 24-70 mm			
5	Speedlight			

Shënim:

- Numrat rendor i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 7 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit".
- Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Konkretisht në kolonën E, të tabelës, operatorët ekonomikë duhet të japin një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike për artikujt e specifikuar, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 6 të DT.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetdeklarim që:

- merr përsipër furnizimin, transportin, instalimin, konfigurimin dhe vënien në punë të pajisjeve objekt prokurimi.
- garancia e mallrave do të jetë jo më pak se 1 vit ose më shumë nëse kërkohet ndryshe në specifikimet teknike, nga momenti i lëvrimit të tyre.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nënën të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nënën 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, lidhen drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se mallrat që do të furnizojë do të jenë origjinale e cilësore.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributorë gjatë procesit të furnizimit/vendosjes e instalimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë, si dhe me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara mbi prodhuesin.

Gjithashtu OE duhet të paraqesin katalogë/ broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/eve, për artikujt e cilësuar të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë prodhuesin, markën dhe modelin e mallit që ofertojnë, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike me kërkesat në DT dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues.

Kërkesa për autorizimin e prodhuesve/distributorit dhe katalogut është vendosur vetëm për pajisjet kryesore që kanë nevojë për instalim, konfigurim dhe vënie në punë.

Deklaratat janë kërkuar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të garantojë cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të artikujve që e kanë të domosdoshëm montimin, konfigurimin dhe menaxhimin e ngritjes së komplet rrjetit multimedial, si dhe do të kryejë transportin deri në destinacion dhe do të mbulojë dëmtimet brenda periudhës së garancisë.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nënën 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- Garancia (skadencia) e mallrave do të jetë jo më pak se 1 vit ose më shumë nëse kërkohet ndryshe në specifikimet teknike, nga momenti i lëvrimit të tyre.
- OE duhet të marrë përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave të furnizuara në adresën fundore të njësisë së AK.
- OE duhet të marrë masa paraprake që në momentin e hartimit të ofertës teknike të mos dalin probleme me cilësinë gjatë zbatimit të kontratës.
- Nëse është përmendur ndonjë markë, është për efekt të saktësisimit të llojit të pajisjes për të cilin kërkohet artikulli, i cili mund të jetë edhe ekuivalent, por gjithnjë duke plotësuar specifikimet e kërkuara nga AK.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Blerje aparat fotografik profesional” (për Policinë Bashkiake)**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin për pajisjet, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën **“Blerje aparat fotografik profesional” (për Policinë Bashkiake)**”.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për aparatë fotografikë që kanë strukturat e Policisë Bashkiake, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimet teknike

Termet e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e e dokumentave standarte të tenderit, për procedurën me objekt: “Blerje aparat fotografik profesional” (për Policinë Bashkiake), si më poshtë:

1. APARAT FOTOGRAFIK PROFESIONAL

Dimensionet (GjxLxTh) 150,7 x 116,4 x 75,9mm

Pesha (vetëm trupi) Approx. 800 g

Specifikimet në detaje.

Image Sensor Type 36 x 24mm CMOS

Pikselët Efektive Approx. 0,4 megapiksel

Piksel Gjithsej Approx. 31,7 megapiksel

Raporti i Pamjes 3:2

Imazhi Type DIGIC 6+

Lentja Vendosja e Lentës EF (duke përjashtuar lentet EF-S / EF-M)

Gjatësia Vatrore I barasvlefshëm me 1,0x gjatësia vatrore e lentes

AF AI Servo Zgjedhja e pikës AF

Zgjedhje automatike: Të gjitha 61 pika AF (bazuar në konfigurimin EOS iTR AF)

Zgjedhja manuale: një pikë AF (mund të zgjidhen pikat 61, 15, 9 ose mund të zgjidhen vetëm pikat e tipit të kryqëzuar)

Zgjedhje manuale: 23°C, ISO100, me matës vlerësues) Bllokimi AE Auto: Në metodën One-Shot me matës vlerësues, kyç i AE hyn në efekt kur arrihet fokusi Manual: Me butonin e kyçit AE në metodat P, Av, Tv dhe M

Kompensimi i Ekspozimit

Ndjeshmëria ISO Auto 100-32000 (në ndarje ndalesash 1/3-stop ose ndalesa të plota) ISO mund të zgjerohet në L:50, H1: 51200, H2 102400 2

Shkrehësi Type Shkrehësi vatrore i rrafshët i kontrolluar elektronikisht Shpejtësia 30- 1/8000 sek (në rritje me ndalesa 1/2 ose 1/3), Lampa (sfera gjithsej e shpejtësisë së shkrehësit.

Prizmi penta Mbulesa (Vertikale/Horizontale) Approx. 100% Magnification Approx. 0,71 x 3 Pika e syrit Approx. 21 mm (nga qendra e lentës të pikës së syrit) Korrigjim i Dioptrisë -3 deri *1 m-1 (dioptrë)

Memoria Type I x CompactFlash Type I (i pajtueshem me UDMA 7) (1 pajtueshem me Type II dhe Microdrive) 1x SD/SDHC/SDXC

Burimi i Energjisë Bateri /Bateri e rikarikueshme Li-ion LP-E6N (e përfshirë) / LP-E6

2. LENTE 70-200MM F/2.8L IS III USM

Specifikimet

Gjatësia e barasvlershme fokale me film 35mm (mm)

Numri i fletëve të diafragmës 8

Apertura minimale 32

Distanca minimale e fokusimit (m) 1.2

Zmadhimi maksimal (x) 0,21 (në 200mm)

Informacioni mbi largësinë Po

Fotostabilizues OIS¹ 3,5²

Aktuatori i vetëfokusimit USM me unazë³

Aksesorët

Kapak u i lentes E-77II

Kapak u i Lentes ET-87

Kasa/Çanta e objektivit LZ 1326

Kapaku fundor i pasmë

Kapak lente E për pluhurat

Zmadhimi me tubin zgjatues EF 12 II 0.28 - 0.06

Zmadhimi me tubin zgjatues EF25 II 0.36 - 0.14

Përputhshmëria e zgjatuesit: I pajtueshëm

Specifikimet fizike

Rezistenca ndaj pluhurit/lagështirës Po⁴

Diametri i filtrit (mm) 77

Diametri x gjatësia maks. (mm)⁵ 88,8 x 199

Pesha (g) 1480

3. LENTE 35MM F/1.4L II USM

SPECIFIKIMET

Këndi i parjes (horizontal, vertikal, diagonal) 54°, 38°, 63°

Ndërtimi i lentës (elementë/grupe) 14/11

Nr. i teheve të diafragmës 9

Rapja minimale 22

Distanca më e afërt e fokusimit (m) 0.28

Zmadhimi maksimal (x) 0.21

Informacioni mbi largësinë Po

Aktualizuesi AF Unazë USM'

Qëndrueshmëria ndaj pluhurit/lagështirës* Po

Diametri i filtrit (mm) 72

Maks. diametër x gjatësi (mm) 80,4 x 104,4

Pesha (g) 760

PAJISJET SHITESË

Kapak lenteje E-7211

Kapaku i lentës EW-77B

Kasa/qesja e lentes LP1219

Kapak i pasmë Kapak E për pluhurin e lentës

Tub Zgjatimi me Zmadhim EF12 II 0,58-0,36

Tub Zgjatimi me Zmadhim EF25 U 1,03-0,80

4. LENTE 24-70 MM F/2.8L II USM

Specifikimet

Gjatësi fokale e barasvlefshme me film 35 mm (mm)

Këndi i parjes (horizontal, vertikl, diagonal) 74° - 29°. 53° - 19°30', 84° - 34°

Ndërtimi i lentës (elementü/grupe) 18/13

Jo. i teheve të diafragmës 9

Hapja minimale 22

Distanca më e afërt e fokusimit (m) 0,38 (Makro)

Zmadhimi maksimal (x) 0,21 (në 70mm) Informacioni mbi largësinë Sigurohet

Stabilizator imazhi Aktualizuesi AF Unazë USM

SPECIFIKIMET FIZIKE

Qëndrueshmëria ndaj pluhurit/lagështirës Po'

Diametri i filtrit (mm) 82

Maks. diametër x gjatësi (mm) 88,5 x 113

Pesha (g) 805

PAJISJET SIITESË

Kapak për lentin E-82U / E-82II

Kapaku i lentes EW-88C

Kasa/qesja e lentes LP1219

Tubi Zmadhimit: Zgjerimi EF12 II 0,63- 0,18

Tubi Zmadhimit: Zgjerimi EF25 II 0,74 x 0,41

5. SPEEDLITE EL-5

SPECIFIKIMET

Specifikimet fizike

Dimensionet (Gj x Th x L) Afro 80,2 x 139,9 x 123.3mm

Pesha Afro 491g (vetëm trupi)

Numri i udhëzuesve (ISO100) metra 60 (200mm)

Zmadhimi i kokës Automatik/Me Dorë

Mbulesa e gjatësisë fokale 24-200mm

Mbulimi me panelin e gjerë 14mm

Vetëzmadhimi për madhësinë e sensorit Po

Kontrolli i vetekspozimit E-TTL II / E-TTL

Sinkronizimi me shpejtësi të lartë (FP)
Parainetrat manualë/të rezultatit Po - 1/1 deri 1/1024
Hapat manualë 1/3 nivele
Blice të vazhdueshme në seri
Maksimumi në fuqi të plotë: afro 85
Paranietrat stroboskopikë/të rezultatit Po - 1/4 - 1/1024
Frekuenca stroboskopike 1 - 500 Hz
Bllokimi FE Po
Memoria FE Po
Kompensimi i Ekspozimit të Blicit ± 3 nivele
Kllapat e Ekspozimit të Blicit ± 3 nivele
Sinkronizimi i perdes së dytë të blicit Po (duke përfshirë lidhjen me valë)
Blici i modelimit Jo (mbështetet vetëm si njësi marrëse jashtë kamere)
Llamba e modelimit Po, 2 llamba të bardha (kohëzgjatje e zgjedhshme nga përdoruesi dhe 5 nivele ndriçimi)
Komunikimi i informacionit të temperaturës së ngjyrës Po
Blici me vale Transmetuesi
Lloji i transmetimit Vetëm radio
Rrezja e transmetuesit 30m (afërsisht)
Ndihma AF
Rrezja ndihmëse e vetëfokusimit Llambë LED dyshe e bardhë

Aksesorë

Karikuesi i baterisë LC-E6E
Karikues makine me bateri CBC-E6
Pako baterie LP-EL
Çanta e Speedlite
Minimbështetësja
Kapak bazamenti montim

** Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shoqëritë ofertuese duhet të përmbushin këto kushte:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë deklaratorë për periudhën e garancisë së pajisjeve (jo më pak se një vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen, dhe shërbimin e gjithë pajisjeve *pa pagesë* konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e çdo pjese të pajisjeve (ose pajisje) në rast difekti për një periudhë 1 vjeçare nga dita e dorëzimit të mallit. Aparatet duhet të kenë çantën përkatëse (dhe me rrip të gjatë) të aparatit dhe të jenë të pajisur dhe me kartë memorie (2 copë) për secilin aparat.

Afatet e lëvrimit dhe vendi i dorëzimit të mallit:

Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor. E gjithë sasia e mallit të sillet brenda 20 ditëve pune nga lidhja e kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje aparat fotografik profesional”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT